



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1879, datë 19.04.2012**

**Për**

**“Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.02.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit””.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.04.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.02.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelecom sh.a., për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”**

## BAZA LIGJORE:

- Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
- Neni 137, e vijues të Ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
- Rregullore nr. 23, datë 29.6.2012 “Për zgjedhjen e bartësit dhe parazgjedhjen e bartësit”, miratuar me Vendim nr. 1650, datë 29.6.2011, i ndryshuar;
- Pika 17, e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të Ligjit nr. 9918;

## K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa me nr. 148 Prot., datë 23.03.2012, (AKEP: nr. 560 prot, datë 26.03.2012 e sipërmarrësit Neofone sh.p.k, i cili ka paraqitur anikimin administrativ ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.02.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelcom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”;
  - Vendimit nr. 1778, datë 20.02.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelcom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”;
  - Rregullore nr. 23, datë 29.6.2012 “Për zgjedhjen e bartësit dhe parazgjedhjen e bartësit”, miratuar me Vendim nr. 1650, datë 29.6.2011, i ndryshuar;
  - Projektvendimin Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.02.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelcom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”;
  - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
- si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

- I. Neofone sh.p.k., në ankimin administrativ me nr. 148 Prot., datë 23.03.2012, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1778, datë 20.02.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelcom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”*”, parashtron si më poshtë vijon:
  1. Neofone në procesin e P(Z)B specifikisht ndaj Vendimit nr. 1778, datë 20.2.2012 të Këshillit Drejtues të AKEP ka konstatuar se disa elemente rregullatore janë në disfavor të

- mbrojtjes së konkurences së lirë, hapjes së tregut dhe uljes së tarifave për abonentin fundor në lidhje me ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike elektronike;
2. Neofone vlerëson se referenca dhe analogjia që Albtelcom ka bërë me British Telecom është jashtë objektivit krahasimor, e vetmja ngjashmëri është që të dy janë operator incumbent;
  3. Në lidhje me pikën 8 të seksionit vëren të Vendimi nr. 1778, datë 20.02.2012 Neofone thekson se megjithatë Albtelcom nuk mund të përcaktoj saktë kostot për shërbimin e P(Z)B, ekzistojnë benchmark-r të cilave AKEP mund tu referohet për përcaktimin e tarifave të P(Z)B për Albtelcom, të cilat janë:
    - a) Benchmark i tarifës së origjinimit/terminimit;
    - b) Benchmark i shërbimeve analoge.
  4. Neofone thekson se shërbimi i OSHKP dhe ZB janë shërbime të akses origjinimit në nivel shumice bazuar në tregjet me rëndësi (Relevant Markets) sipas definicionit të Komisionit Europian;
  5. Neofone pretendon se e vetmja diferencë midis dy shërbimeve është përdorimi i platformës IVR nga ana e operatorëve alternativë. Nisur nga kjo analogji shërbimi i zgjedhjes së bartësit ka të njëjtat kosto implementimi si shërbimi OSHKP dhe si rrjedhim logjik është i arsyeshëm përcaktimi i kostove të zgjedhjes së Bartësit sipas kostove të përcaktuara tashmë për shërbimin OSHKP;
  6. Neofone pretendon se pagesa fikse e vendosur nga AKEP tek Vendimi nr. 1778, datë 20.02.2012, për implementimin fillestar të P(Z)B në nivelin 5.000.000 lek është një tarifë e lartë dhe abuzive, pasi kjo tarifë nisur nga kushtet e tregut Shqiptar përbën:
    - NJë barierë artificiale për futjen në treg të operatorëve të tjerë;
    - Nuk reflekton asnjë kosto dhe është e pa bazuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008;Neofone sqaron se në rastin e implementimit të një lidhje të re aksesit dhe interkoneksioni me Albtelcom apo edhe me operatorët mobile, operatorët alternativë janë të detyruar të paguajnë tarifën e instalimit për çdo sistem 2 Mbi/s+kosto bashkvendosje mujore.
  7. Neofone vlerëson se, vlera e instalimit fillestar për P(Z)B, e cila përfaqëson vetëm një copëz të shërbimeve të aksesit interkoneksionit të ket një lloj kosto gati 40-50 herë më të lartë se implementimi i aksesit dhe interkoneksionit.
  8. Neofone vlerëson se instalimi fillestar për vendosjen e kodeve të aksesit të ZPB kushton 36.7 here më shumë se instalimi i kapaciteteve fizike dhe logjike të aksesit interkoneksionit për çdo sistem 2 Mbit/sek (që paguhet vetëm një herë);
  9. Neofone i kërkon AKEP ndërhyrjen e menjëhershme në vendosjen e tarifës për implementimin e P(Z)B në nivele të pranueshme dhe të bazuara në kostot reale duke marrë parasysh Benchmark-un aktual të tregut.
  10. Së fundmi Neofon propozon që pagesa për implementimin dhe aktivizimin e prefiksit për Z(P)B e shprehur në tarifë për të gjitha centralet (paguhet vetëm njëherë) të jetë më e vogël se 136.000 leke.

- II.** AKEP për sa i përket pretendimeve të ngritura në ankimimin administrativ të sipërmarrësit Neofone sh.p.k., arsyeton si më poshtë:
1. AKEP në përcaktimin e vlerave të tarifave të Albtelecom ka përdorur pikërisht për referencë nivelet e tarifave të aplikuara në vendet e tjera dhe sidomos të rajonit. Këto tarifa janë dhënë nga AKEP në Tabelat 1 dhe 2 (pikat 10 dhe 11) të arsyetimit të VKD nr. 1778, datë 20.02.2012, dhe në këtë mënyrë një sërë pretendimesh të Neofone për mos-përdorim të tarifave benchmark nuk qëndrojnë;
  2. Pretendimi i Neofone se shërbimi i ZPB dhe i OSHKP nuk ka ndryshim tjetër përveç përdorimit të platformës IVR nga OSHKP, është i vërtetë për sa i përket ofrimit nga OSHKP, ndërsa mundësi nga Albtelecom është i ndryshëm. AKEP ka theksuar që në dokumentin për konsultim publik për rregulloren e Z(P)B se implementimi i Z(P)B nga Albtelecom gjeneron disa kosto të tjera përveç kostove të origjinimit të thirrjeve, dhe kjo është cituar edhe në pikën 5 të arsyetimit VKD nr. 1778, datë 20.02.2012, si dhe nga informacioni i dhënë për tarifën e aplikuara në vendet e tjera.
  3. Krahasimi që Neofone i bën shërbimit të implementimit të kodit të Z(P)B dhe instalimit të një qark 2Mb nuk është i saktë pasi janë dy shërbime krejt të ndryshme. Në këtë mënyrë propozimi që këto tarifa të jene të njëjta nuk është i pranueshëm nga AKEP.
  4. Për sa i përket nivelit të tarifës së implementimit të Z(P)B, AKEP e ka përcaktuar këtë nivel rreth nivelit mesatar të vendeve të rajonit, duke marrë në konsideratë edhe tarifën mujore në vende që aplikohet një tarifë e tillë. Maqedonia që ka vlerë të ulët instalimi (pagese one-off) ka vlerë të lartë pagese mujore (250 mijë lekë/muaj). Vlera e përcaktuar nga AKEP është tarifë që paguhet vetëm një herë dhe operatori nuk ka detyrimin të paguajë çdo muaj Albtelecom. AKEP gjithashtu, nuk ka pranuar propozimet e Albtelecom për një sërë tarifash të tjera për Z(P)B, të cituara në pikën 4 të arsyetimit VKD nr. 1778, datë 20.02.2012, aplikimi i të cilave do të rezultonte në kosto shumë më të lartë të Z(P)B për operatorët e tjerë.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, pika a, të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

### **V E N D O S:**

1. Rrëzimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k me nr. 148 prot., datë 19.05.2011 (AKEP: nr. 703/7 prot, datë 23.05.2011) *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 1778, datë 20.02.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”*;
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1778 datë 20.2.2012 të Këshillit Drejtues, *“Për miratimin e tarifave të Albtelecom për ofrimin e shërbimit të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit”*;
3. Të njoftohet Neofone sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;

4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURÇE**